



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 00.00.2025

Nr: 00

Ora: 00:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN ME NR. 58 ID, DATË
11.03.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË Z. ERION MURATAJ**

Sot më datë 00.00.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Z. Erion Murataj

SUBJEKT: Z. Gledian Llatja
Kryetar për Bashkinë Elbasan

OBJEKT: Veprimtari të institucioneve publike

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, nenit 91, ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Z. Erion Murataj, më datë 11.03.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet portalit, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 58 ID.

Në këtë denoncim, z. Murataj parashtrohet sa vijon:

Data: xx.0x.2025 Nr:

Ora: xx:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 58 ID, datë 11.03.2025, të regjistrin të denoncimeve, të z. Erion Murataj”

“Bashkia Elbasan, ka shpërndarë në rrjetet e saj sociale inaugurimin e rrugëve dhe shërbime të tjera që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në votën e zgjedhësve sipas provave bashkëlidhur. ”

Me vendimin nr. 288, datë 20.03.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim i'u kërkuar personave përgjegjës në Bashkinë Elbasan, të paraqesin prapësimet e tyre në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Më datë 18.03.2025, KQZ administroi pretendimet e personit përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike nga Bashkia Elbasan, të dërguara me email në KQZ, i cili deklaroi se:

“Me vendimin e Këshillit Bashkiak Elbasan nr.126, datë 26.12.2024 është miratuar buxheti i Bashkisë Elbasan për periudhën 2024-2026 në të cilën parashikohet: Rikonstruksion dhe ri-asfaltim i rrugës rurale në Njësinë Administrative Shushicë dhe ndërtimi i shkollës 9 vjeçare "Jonuz Çarçiu" në Tregan me bashkëfinancim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Lidhur me investimet për ndërtimin e mureve mbrojtëse në përroin e "Gurrës" dhe programit social të strehimit sqarojmë se këto fonde janë akorduar përkatësisht nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, dhe buxheti i shtetit gjatë vitit 2024”.

Më datë 00.00.2025, ora 00:00, u zhvillua seanca publike për këtë shqyrtim administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f”, “n”, neni, 91 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. _____
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 0x.0x.2025 Nr:

Ora: xx:00



“Për shqyrtimin administrativ, bazuar në denoncimin me nr. 58 ID, datë 11.03.2025, të regjistratit të denoncimeve, të z. Erion Murataj”